

Uniteti islamik, rrugë efikase në luftën kundër Islamofobisë



Ndodhemi në ditët e përvjetorit të lindjes së Profetit të mëshirës, hazretit Muhamed (savs). Në lidhje me ditëlindjen e Profetit të Islamit ekzistojnë dy hipoteza.

Shumica e myslimanëve sunitë janë të mendimit se Profeti i Islamit ka lindur më 12 Rabiul Aval në vitin e elefantit, që përkon me vitin 570 sipas kalendarit kristian. Një grup tjetër myslimanësh kryesisht shi'itë, janë të mendimit se hazreti

Muhamed (savs) ka lindur në datën 17 Rabiul Aval të po atij viti. Diferenca mes dy hipotezave është një javë dhe me propozim të imam Khomeinit (ra) themeluesit të sistemit të RII, kjo javë është quajtur "Java e unitetit". Një nga rreziqet serioze që gjithmonë ka kërcënuar shoqëritë islame gjatë disa shekujve të kaluar, janë mosmarrëveshjet mes sekteve të ndryshme islame dhe inkurajimi i këtyre mosmarrëveshjeve nga armiqtë e Islamit. Ndërkohë, të përbashkëtat mes sekteve islame janë shumë më të mëdha, sesa mosmarrëveshjet mes tyre. Themeluesi i RII imam Khomeini (ra) duke e kuptuar drejtë këtë rrezik, i ftoi myslimanët në unitet dhe në dhënien fund të mosmarrëveshjeve. Edhe emërimi i javës së unitetit ka për qëllim të dëshmojë se myslimanët megjithë mosmarrëveshjet në disa çështje historike dhe fetare, përbëjnë një Ummet të bashkuar. Kanë kaluar rreth 3 dekada që nga emërimi i javës së unitetit dhe sot Bota islame për tu bërë ballë kërcënimeve më shumë se kurrë ka nevojë për unitet. Komplotet e armiqve të islamit janë bërë më të ndërlikuara dhe për tu bërë ballë këtyre kompleteve nevojitet më shumë vigjilencë nga Ummeti islamik. Një nga këto komplete të thurura nga qeveritë perëndimore është nxitja e islamofobisë. Një nga qëllimet e propagandës anti-islamike në perëndim, është frikësimi i popujve perëndimorë nga Islami. Në këtë lloj propagande duke u shfrytëzuar mjete të ndryshme si filmi, libri, mediat dhe interneti, prezantohet një imazh i rrezikshëm i Islamit. Më pas, tek opinioni publik krijohet bindja se islami është duke u zgjeruar dhe së shpejti do të përfshijë Europën dhe Amerikën. Ata duke pretenduar se Islami është një fe e dhunshme dhe kundërshtarë e të drejtave të njeriut, përpiqen t'i trembin popujt perëndimorë nga progresi i Islamit. Por megjithë këto përpjekje, faktet tregojnë se një numër i madh i njerëzve në perëndim kanë fituar prirje drejt islamit. Ata arsyen e prirjes së tyre drejt islamit, konsiderojnë vlerat e larta dhe udhëzimet logjike e universale të kësaj feje. Myslimanët e rinj që kryesisht janë nga shtresa e arsimuar dhe intelektuale e perëndimit, e kanë përqafuar Islamin me vullnet të plotë dhe pas studimeve të shumta. Zgjerimi i popullsisë myslimane dhe prirja e popujve perëndimorë drejt islamit, si dhe ulja e popullsisë në vendet evropiane, ka shkaktuar shqetësim të thellë tek pushtetarët perëndimorë. Kjo çështje i ka shtuar motivacionet e qeverive perëndimore, për të zgjeruar valën e islamofobisë. Lavia Safi drejtore ekzekutive e organizatës islamike të Amerikës së veriut në lidhje me qëllimet e rrymës islamofobe thotë: " Islamofobia është një armë strategjike që shfrytëzohet për të lënë në hije myslimanët".

Rryma e islamofobisë me zgjerimin e industrisë së informacionit është shndërruar në një rrymë kryesore në perëndim. Orientimi i mediave perëndimore sidomos në fushën e artit dhe kinemasë, dëshmon se lufta ndaj zgjerimit të Islamit nëpërmjet tjetërsimit të besimeve të myslimanëve dhe

krijimit të përçarjes mes tyre, është boshti kryesor i politikës kulturore të vendeve perëndimore përballë botës islame. Islamofobia në perëndim mund të vërehet në forma të ndryshme si tallje, ofeza, poshtërim, spekulim, mashtrim dhe kërcënim. Në botën e sotme aparatet propagandistike të perëndimit duke shfrytëzuar mediat synojnë të mbjellin përçarje në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar mes popujve myslimanë. Nxitja e përçarjeve në nivel kombëtar në vendet islamike, që bëhet shkak për mosmarrëveshje, madje dhe luftë të brendshme në një vend islamik, është një prej politikave të qeverive perëndimore për pengimin e unitetit të botës islame. Kjo për faktin se në një kohë që vendet islamike përfshihen nga konflikte dhe lufta të brendshme, natyrisht nuk mund të ndihmojnë botën islame për të krijuar një union të madh. Si rezultat, mosmarrëveshjet në nivel kombëtar kthehen në mosmarrëveshje në mesin e botës islame. P.sh, mediat perëndimore kanë luajtur rol kryesor në krijimin e mosmarrëveshjeve mes myslimanëve dhe mes grupeve kombëtare dhe islamike në Palestinë, Liban dhe në rajonin e Kaukazit. Rryma e Islamofobisë është një fenomen me elementë të komplikuar dhe përmasa të gjera, me ndikime të thella. Si rrjedhim, për ti bërë ballë kësaj rryme nevojitet të bëhen përpjekje të shumta në botën islame. Një nga rrugët efikase për tu konfrontuar me islamofobinë është uniteti islamik. Popujt dhe qeveritë islamike saherë që kanë reaguar bashkërisht ndaj formave të ndryshme të Islamofobisë, perëndimi është detyruar të tërhiqet. Reagimi i botës islame ndaj publikimit të librit "Vargjet satanike" të shkrimtarit blasfemik Selman Rushdi në Angli, në fund të viteve 80' të shekullit të kaluar, e dëshmoi më së miri këtë. Kur lideri i madh i Revolucionit Islamik, imam Khomeini (ra), e dënoi me vdekje Selman Rushdiun për ofezat ndaj Profetit të madh të Islamit, vendet e BE menjëherë thirrën ambasadorët e tyre nga Teherani. Por reagimi i të gjitha vendeve islamike dhe i myslimanëve me banim në Europë ndaj botimit të librit plot mashtrime dhe ofeza të Selman Rushdiut, demonstroi forcën e Ummetit të bashkuar islamik përballë rrymës islamofobe në perëndim. Pas këtij reagimi, qeveritë perëndimore hoqën dorë nga përkrahja e hapur për Selman Rushdiun dhe ambasadorët e vendeve të BE, njëri pas tjetrit u rikthyen në Teheran. Në vitet pas ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001 ku filloi një valë e re e Islamofobisë, saherë që myslimanët janë ngritur njëzëri ndaj rrymës islamofobe, perëndimi është detyruar të tërhiqet. Pas ofezës së Papës Benedikti XVI kundër Islamit në vitin 2006, si dhe pas publikimit të karikaturave ofenduese kundër Profetit të islamit në vitin 2007, myslimanët u ngritën në protesta masive. Ky unitet i Ummetit islam në mbrojtje të verave të shenjta islamike, i detyroi ofenduesit të tërhiqen. Si rezultat, saherë që Ummeti islamik ka protestuar i bashkuar kundër propagandave keqdashëse të perëndimit, perëndimi nuk ka patur rrugë tjetër veç dorëzimit përballë logjikës së ndjekësve të Islamit. Një nga mjetet e tjera efikase në luftën kundër islamofobisë në perëndim është shfrytëzimi i mediave dhe shkëmbimi i mendimeve në shoqëritë islamike. Aktualisht qeveritë perëndimore me fuqinë e mediave të ndryshme përpiqen që myslimanët me banim në perëndim dhe shoqëritë islamike t'i distancojnë nga vlerat islamike të bazuara në dashurinë dhe tolerancën humane. Edhe myslimanët munden që me të tilla mjete të zhvillojnë një luftë mediatike për tu përballur me agresionin mediatik të nisur nga perëndimi kundër islamit. Vendet islamike me unitet dhe koordinim mund të përdorin mediat dhe mjetet kulturore për prezantimin e islamit të vërtetë dhe të vlerave të tij të larta. Uniteti dhe integrimi në këtë fushë ka aspekte të ndryshme që përfshijnë aspektin mediatik dhe informativ, (televizionin, radion, mediat, libraritë), aspektin artistik dhe sportiv (shkëmbimin e artistëve dhe sportistëve, eksportimin dhe importimin e produkteve kulturore dhe organizimin e festivaleve), aspektin fetar (dialogu ndër fetar) dhe aspekti kulturor dhe shkencor ku përfshihen shkëmbimet shkencore, universitare si dhe kontaktet mes profesorëve dhe studentëve të vendeve të ndryshme islamike. Në përfundim mund të kujtojmë faktin se feja islame është burim i krijimit të një civilizimi të pasur e të

pakrahasueshëm. Islami është një fe gjithëpërfshirëse që u kushton vëmendje të gjitha aspekteve politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe shpirtërore të njerëzve. Sot në botë ndihet nevoja e madhe për njohjen me islamin dhe dijetarët dhe intelektualët myslimanë si dhe qeveritë islamike kanë një rol thelbësor në prezantimin e imazhit të ndritur të Islamit. Numri i madh i atyre që kanë përqafuar islamin megjithë ekzistencën e rrymave islamofobe, dëshmon se njerëzimi nuk e ka humbur rrugën dhe ka nevojë të vendoset nën hijen e udhëzimeve jetëdhënëse të fesë së fundit hyjnore për tu ndarë një herë e përgjithmonë nga idetë e zbrazëta dhe devijuese.

Marre nga: <http://albanian.tribuna.com>